REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Edukimit Parauniversitar

Nr 4738/11 Prot.

Tiranë, më 27.08.2012

MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAFAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS TIRANË

# SKELETKURRIKUL

Për Drejtimin Mësimor

# TEKSTIL-KONFEKSIONE

Niveli III

(1 vjeçar)

KODI: D-III-12

Tiranë, Gusht 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# SKELETKURRIKULI

## Për Drejtimin Mësimor

# TEKSTIL-KONFEKSIONE

## Niveli III
**(1 vjeçar)**

**Kodi: D-III-12**

Miratoi:

MINISTRI

**MYQEREM TAFAJ**

## Tiranë, 2012

## Përmbajtja:


**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.
3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.

**III. Plani mësimor për drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

# I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e veshjeve apo aksesorëve prej pëlhure të endur, të thurur dhe prej lëkure, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

# II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III.

## 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III. kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit II të drejtimin mësimor “Tekstil-konfeksione”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

## 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

## 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion që lidhen me veprimtaritë profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të zbatojë standartet teknike të profesionit përkatës.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale të drejtimit "Tekstil-konfeksione".
- Të identifikojë tendencat e modës gjatë periudhave kohore të shkuara
- Të analizojë periudhat historike që kanë influencuar historinë e modës
- Të vizatojë format bazë të veshjeve
- Të krijojë forma të reja të veshjeve
- Të analizojë elementët dhe procedurat bazë për krijimin, realizimin dhe prezantimin e një koleksioni
- Të ndërtojë një skemë të programimit të përgjithshëm për krijimin, realizimin dhe prezantimin e një koleksioni
- Të krijojë një strategji të marketingut të modës
- Të mbledhe informacion paraprak mbi ngjyrat dhe tendencën e modës

- Të përdorë informacionin e marrë për krijimin e koleksionit.
- Të dizenjojë koleksionin me temë tendence.
- Të krijojë arkivën me modele bazë në sistemin CAD/CAM.
- Të ndërtojë skicat teknike të koleksionit me teknikën tradicionale dhe me ndihmën e sistemit CAD/CAM.
- Të ndërtojë kallëpet përkatëse të modeleve të koleksionit.
- Të zhvillojë vendosjen grafike të elementëve përbërës të artikullit të koleksionit në skicë.
- Të përzgjedhë lëndën e parë dhe materialet ndihmëse për realizimin e koleksionit.
- Të realizojë modelin e ri të koleksionit në pëlhurë tekstili, trikotazhi apo lëkurë.
- Të kryejë provën e modelit.
- Të realizojë modelet e koleksionit në pëlhurë tekstili, trikotazhi apo lëkurë.
- Të sintetizojë të gjithë informacionin e mbledhur për të përfunduar koleksionin.
- Të realizojë një përmbledhje lidhur me skicat, imazhin, ngjyrat dhe aksesorët e koleksionit.
- Të prezantojë koleksionin.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime profesionale.

**4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut të tekstil-konfeksioneve. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në të gjitha bisneset e vogla artizanale të rrobaqepsive, galanterive apo tekstilit. Nxënësi mund të punësohet në të gjithë sektorët e industrisë së veshjeve apo të tekstilit. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e rrobaqepësisë, galanterisë dhe tekstilit.
Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

## III. Plani mësimor për drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III.

| Plani mësimor për drejtimin "Tekstil-konfeksione", niveli III. | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 13** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **15/17** (510/578) |
| 1 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 2 |
| 2 | | Gjuhë e huaj | 2 |
| 3 | | Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë) | (2) |
| 4 | | Histori | 2 |
| 5 | | Gjeografi | 2 |
| 6 | | Matematikë | 2 |
| 7 | | Biologji | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8 | | Teknologji informimi e komunikimi | 1 |
| 9 | | Lëndë me zgjedhje të detyruar<br>(Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti) | 2 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **9** (306) |
| 1 | L-17-197-11 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-05-198-12 | Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm | 1 |
| 3 | L-17-291-12 | Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve | 1 |
| 4 | L-26-292-12 | Hyrje në sistemin CAD/CAM | 1 |
| 5 | L-10-293-12 | Histori e kostumeve dhe e modës | 1 |
| 6 | L-10-294-12 | Koleksioni dhe marketingu i modës | 2 |
| 7 | L-10-295-12 | Stilim i veshjeve | 1 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **6** (204) |
| 1 | M-10-851-12 | Blloku i tendencave të modës | 33 |
| 2 | M-10-852-12 | Dizenjimi në tekstil konfeksione | 51 |
| 3 | M-10-853-12 | Ndërtimi i kallëpeve në tekstil-konfeksione | 51 |
| 4 | M-10-854-12 | Realizimi i prototipit dhe prezantimi i koleksionit | 69 |
| | | **Gjithsej A+B+C** | **30/32** (1020/ 1088) |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).
Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në në drejtimin “Tekstil-konfeksione”, niveli III, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të

arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor "Tekstil-konfeksione", niveli III.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së "*lojës me role*", ku nxënësve t'u jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional "Tekstil-konfeksione".
Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimit mësimor "Tekstil-konfeksione", niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASH.

## VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor "Tekstil-konfeksione", niveli III.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor "Tekstil-konfeksione", niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut të tekstil-konfeksionit, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;
- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

# VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

## 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 13 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin i saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të dallojne tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojen për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet dhe mjetet e nevojshme për të garantuar sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit, si dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Sipërmarrja dhe menaxhimi | **4 orë** |
| **Tema 2** | Sipërmarrja dhe biznesi | **5 orë** |
| **Tema 3** | Aftësitë menaxheriale | **8 orë** |
| **Tema 4** | Funksionet dhe teknikat e menaxhimit | **5 orë** |
| **Tema 5** | Menaxhimi i burimeve njerëzore | **7 orë** |
| **Tema 6** | Menaxhimi i informacionit | **6 orë** |
| **Tema 7** | Menaxhimi marketing | **5 orë** |
| **Tema 8** | Menaxhimi financiar | **9 orë** |
| **Tema 9** | Zhvillimi i një plani biznesi | **7 orë** |
| **Tema 10** | Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit | **7 orë** |
| **Tema 11** | Kuadri ligjor dhe taksat | **5 orë** |





## 2. Lënda "Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm" (L-05-198-12). Kl.13 – 34 orë

- **Synimet e lëndës "Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm", kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm", kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për "mjedisin" dhe "mbrojtjen e mjedisit".
- Të shpjegojnë kuptimin për "zhvillimin e qëndrueshëm"
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm", kl.13 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm | 2 orë |
| **Tema 2** | Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor | 3 orë |
| **Tema 3** | Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis. | 3 orë |
| **Tema 4** | Zhvillimet demografike dhe mjedisi | 4 orë |
| **Tema 5** | Shoqëria e konsumit dhe mbetjet | 4 orë |
| **Tema 6** | Monitorimi i burimeve mjedisore | 4 orë |
| **Tema 7** | Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. | 2 orë |
| **Tema 8** | Sistemet e menaxhimit të mjedisit | 3 orë |
| **Tema 9** | Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal. | 3 orë |
| **Tema 10** | Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal | 6 orë |

## 3. Lënda "Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve" (L-17-291-12). Kl. 13 - 34 orë

- **Synimet e lëndës "Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve", kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve", kl 13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë nocionet historike dhe objektivat e organizimit të punës.
- Të interpretojnë organizimin ergonomik të vendit të punës (antropometrik, fiziologjik dhe psikologjik).
- Të argumentojnë ndikimin e analizës së vendit të punës në mirqënien e punonjësit.

- Të analizojnë ndikimin e makinerive, aksesorëve dhe transportit në organizimin e punës në industrinë e tekstil-konfeksioneve.
- Të tregojnë ç'farë është organigrama dhe cili është qëllimi i përdorimit të saj në ndërmarrjet e veshjeve.
- Të përshkruajnë etapat e ciklit të prodhimit në industrinë e veshjeve.
- Të përshkruajnë elementët e sistemit të organizimit të prodhimit.
- Të interpretojnë elementët e një plani operacional dhe shpërndarjeje.
- Të rendisin kriteret e klasifikimit të ndërmarrjeve, bazuar në Ligjin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Të përshkruajnë etapat dhe procedurat ligjore për nisjen e një biznesi të ri në fushën e tekstlit dhe veshjeve.
- Të përshkruajnë format ligjore që pronari mund të zgjedhë për biznesin e tij në fushën e tekstlit dhe veshjeve si dhe të njohë llojet e taksave të parashikuara për tu paguar.
- Të njohin procedurat dhe kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kompania për të eksportuar produktet e gatshme.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve", kl. 13 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Organizimi i punës | 2 orë |
| **Tema 2** | Organizimi ergonomik i vendit të punës | 3 orë |
| **Tema 3** | Analizë e vendit të punës | 2 orë |
| **Tema 4** | Makineritë, aksesorët dhe transporti i materialeve | 2 orë |
| **Tema 5** | Organigrama e ndërmarrjes | 2 orë |
| **Tema 6** | Cikli i prodhimit | 4 orë |
| **Tema 7** | Sistemi i organizimit të prodhimit | 3 orë |
| **Tema 8** | Plani operacional dhe i shpërndarjes | 4 orë |
| **Tema 9** | Biznesi i vogël | 2 orë |
| **Tema 10** | Nisja e një biznesi të ri | 2 orë |
| **Tema 11** | Format ligjore të pronësisë dhe çështjet e taksimit | 4 orë |
| **Tema 12** | Bazat e eksportit | 4 orë |

## 4. Lënda "Hyrje në sistemin CAD/CAM" (L-26-292-12). Kl. 13 - 34 orë

- **Synimet e lëndës "Hyrje në sistemin CAD/CAM", kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Hyrje në sistemin CAD/CAM", kl.13, nxënësit duhet:
- Të përshkruajnë aplikimin e sistemit CAD në industrinë tekstile dhe të veshjeve, si dhe përdorimin e programit TukaCAD, Optitex apo Lectra Modaris në dizenjimin dhe modelimin e veshjeve.
- Të përshkruajnë strukturën e programit, elementët e dritares së programit, si dhe komandat e dizenjimit e të modifikimit të objekteve.
- Të tregojnë mënyrën e ndërtimit të figurave gjeometrike, si katror, drejtkëndësh, rreth, elips, si dhe të ndërtojë xhepin e këmishës.
- Të përshkruajnë komandat e elementëve të veçantë të dizenjimit e modelimit, si dhe komandat e përmasave të objekteve e të emërtimit të tyre.
- Të vendosë shenjat e kopsave, cikatave dhe tolerancës për qepje, si dhe të dizenjojë penca dhe pala.

- Të tregojnë mënyrën e vendosjes së përmasave, emërtimit të objekteve, si dhe të ndërtojë bazën e fundit nëpërmjet programit CAD/CAM.
- Të përshkruajnë metodat e shumëzimit teknik rrezor, proporcional dhe kartezian të elementëve të modeleve.
- Të përshkruajnë përdorimin e modulit Grade, komandat për krijimin, modifikimin dhe finalizimin e shumëzimit teknik.
- Të përshkruajnë metodat e shtrimit të dyshekëve linearë dhe tubolarë të lëndës së parë, si dhe metodat e ekonomizimit të saj nëpërmjet programit TukaMARK.
- Të pozicionojnë elementët përbërës së bazës së fundit, duke ekonomizuar lëndën e parë.
- Të përshkruajnë mënyrën e ndërtimit të bazës së pantallonave për femra, shumëzimin teknik dhe ekonomizimin e lëndës së parë nëpërmjet programit CAD/CAM.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Hyrje në Sistemin CAD/CAM", kl. 13-34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Sistemet CAD/CAM dhe përdorimi i programeve të ndryshme CAD për dizenjimin dhe modelimin e veshjeve. | 2 orë |
| **Tema 2** | Hyrje në programin CAD | 6 orë |
| **Tema 3** | Ndërtimi i figurave gjeometrike si dhe i xhepit të këmishës. | 2 orë |
| **Tema 4** | Komandat e dizenjimit dhe modelimit. | 2 orë |
| **Tema 5** | Vendosja e vendit të kopsave, tolerancës për qepje, cikatjeve si dhe dizenjimi i pencave dhe palave. | 4 orë |
| **Tema 6** | Përmasat dhe emërtimi i objekteve. Ndërtimi i bazës së fundit. | 4 orë |
| **Tema 7** | Shumëzimi teknik i elementëve të modelieve. | 2 orë |
| **Tema 8** | Moduli Grade për shumëzimin teknik të veshjeve. | 4 orë |
| **Tema 9** | Shtrimi i dyshekëve të lëndës së parë dhe ekonomizimi i saj. | 2 orë |
| **Tema 10** | Ekonomizimi i prerjes së bazës së fundit. | 3 orë |
| **Tema 11** | Ndërtimi i bazës së pantallonave për femra, shumëzimi teknik dhe ekonomizimi i tyre. | 3 orë |

## 5. Lënda "Histori e kostumeve dhe e modës" (L-10-293-12). Kl. 13 - 34 orë

- **Synimet e lëndës "Histori e kostumeve dhe e modës" kl. 13 – 34 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Histori e kostumeve dhe e modës apo", kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë karakteristikat bazë të veshjeve në qytetërimet e hershme gjatë antikitetit
- Të përshkruajnë veçoritë e kostumeve dhe modës gjatë mesjetës.
- Të shpjegojnë ndikimin e specializimit të artizanatit, dhe tregtisë në veshje gjatë Mesjetës.
- Të përshkruajnë veçoritë dhe tiparet e kostumeve dhe modës gjatë Rilindjes.
- Të shpjegojnë veçoritë, tiparet e kostumeve dhe kush influencoi në modë në periudhat e ndryshme nga Revolucioni Francez deri në fund të shekullit IXX.
- Të shpjegojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën në fillimshekullin e XX deri në vitet '30.
- Të shpjegojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën e viteve '30.

- Të shpjegojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën e viteve ‘40-’50.
- Të shpjegojnë tregojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën e viteve ’60.
- Të shpjegojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën e viteve 70
- Të shpjegojnë tendencat, siluetat, tekstilet e përdorura dhe çfarë influencoi modën e viteve ‘80-’90.
- Të analizojnë tendencat, tiparet karakteristike të modës gjatë fillimshekullit të XXI.
- Të analizojnë tiparet e kostumeve dhe modës në Shqipëri në vite.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Histori e kostumeve dhe e modës”, kl. 13 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Historia e veshjeve gjatë epokës së Antikitetit | 2 orë |
| **Tema 2** | Historia e kostumeve dhe e modës në Mesjetë | 2 orë |
| **Tema 3** | Historia e kostumeve dhe e modës gjatë Rilindjes deri në Revolucionin Francez | 2 orë |
| **Tema 4** | Historia e kostumeve dhe e modës nga Revolucioni Francez deri në fund të shekullit XIX | 3 orë |
| **Tema 5** | Moda gjatë fillim shekullit të XX deri më vitet ’30 | 4 orë |
| **Tema 6** | Moda gjatë viteve ’30 | 2 orë |
| **Tema 7** | Moda gjatë viteve ’40 -’50 | 3 orë |
| **Tema 8** | Moda gjatë viteve ’60 | 2 orë |
| **Tema 9** | Moda gjatë viteve ’70 | 3 orë |
| **Tema 10** | Moda gjatë viteve ’80 -’90 | 4 orë |
| **Tema 11** | Moda gjatë fillim shekullit të XXI | 4 orë |
| **Tema 12** | Historia e kostumeve dhe e modës në Shqipëri | 3 orë |

## 6. Lënda “Koleksioni dhe marketingu i modës” (L-10-294-12). Kl. 13 - 68 orë

- **Synimet e lëndës “Koleksioni dhe marketingu i modës”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Koleksioni dhe marketingu i modës”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë lidhjen ndërmjet ideve të reja për modele dhe studimit të nevojave dhe dëshirave të njerëzve.
- Të analizojnë elementë bazë për krijimin dhe realizimin e një modeli.
- Të ndërtojnë një skemë të programimit për krijimin dhe realizimin e një modeli.
- Të analizojnë procedurat bazë për krijimin dhe realizimin e një koleksioni.
- Të përshkruajnë mënyrat e ndryshme të prezantimit të koleksionit.
- Të interpretojnë konceptet dhe elementët bazë të marketingut të veshjeve dhe modës.
- Të analizojnë elementët e zhvillimit të një strategjie të marketingut.
- Të interpretojnë marketingun mix të modës, si një kombinim të 4 P-ve (politikave të marketingut).
- Të analizojnë kombinimin e politikave të marketingut mix të modës.
- Të përshkruajnë etapat e procesit të planifikimit të një startegjie të marketingut të modës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Koleksioni dhe marketingu i modës”, kl. 13 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Ideimi i modeleve për industri | 5 orë |
| **Tema 2** | Krijimi i një modeli | 8 orë |
| **Tema 3** | Realizimi i një modeli | 10 orë |
| **Tema 4** | Koleksioni | 4 orë |
| **Tema 5** | Prezantimi i koleksionit | 6 orë |
| **Tema 6** | Hyrje në marketingun e modës | 4 orë |
| **Tema 7** | Strategjia e marketingut | 5 orë |
| **Tema 8** | Marketingu mix | 14 orë |
| **Tema 9** | Kombinimi i politikave të marketingut mix | 6 orë |
| **Tema 10** | Plani i marketingut | 6 orë |

**7. Lënda “Stilim i veshjeve” (L-17-295-12). Kl. 13 - 34 orë**

- **Synimet e lëndës “Stilim i veshjeve”, kl 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Stilim i veshjeve”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të vizatojnë format bazë të veshjeve.
- Të stilojnë modele të ndryshme të palave dhe xhepave.
- Të krijojnë tipe të ndryshme të mëngëve dhe mashetave.
- Të dallojnë llojet kryesore të mëngëve në veshje dhe veçoritë e tyre.
- Të stilojnë lloje të ndryshme të jakave, dekolteve dhe kapuçëve.
- Të vizatojnë tipe të ndryshme të fundeve në trupin e njeriut.
- Të stilojnë tipe të ndryshme të këmishave klasike dhe sportive.
- Të stilojnë tipe të ndryshme të fustaneve në trupin e njeriut.
- Të ndërtojnë tipe të ndyshme të pantallonave.
- Të stilojnë modele të ndryshme xhaketash.
- Të përshkruajnë llojet e ndryshme të stilimit, palltove, pardesyve të mantelit.
- Të përzgjedhin aksesorët (çantat, kapelet, dorezat, rripat).
- Të stilojnë modele të ndryshme të aksesorëve.
- Të përshkruajnë kuptimin mbi stilizimin e figurës së njeriut.
- Të rendisin hapat që ndiqen nga vizatimi deri tek veshja e figurës së njeriut.
- Të krijojnë idenë e formave të veshjes në trupin e njeriut, nëpërmjet përdorimit të dritë hijes.
- Të përdorin teknikat e ngjyrave dhe mundësit shprehëse të tyre në krijimin e stilimit.
- Të përdorin teknikat e akuarelit, temperës e pastelit, në një krijim stilimi.
- Të modelojnë në manikin me pëlhura, duke krijuar forma të reja të veshjeve.
- Të përshkruajnë si projektohet një koleksion veshjesh.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Stilim i veshjeve”, kl. 13 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Njohuri mbi stilimin | 2 orë |
| **Tema 2** | Palat | 1 orë |
| **Tema 3** | Xhepat | 1 orë |
| **Tema 4** | Mëngët dhe mashetat | 2 orë |
| **Tema 5** | Jakat , dekoltetë dhe kapuçët | 3 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 6** | Fundi, këmisha, jeleku | 3 orë |
| **Tema 7** | Fustani | 3 orë |
| **Tema 8** | Pantallonat | 2 orë |
| **Tema 9** | Xhaketat | 3 orë |
| **Tema 10** | Pardesy, mantel, pallto | 3 orë |
| **Tema 11** | Aksesorët | 2 orë |
| **Tema 12** | Stilizimi dhe veshja e figurës së njeriut | 2 orë |
| **Tema 13** | Teknika e ngjyrave | 3 orë |
| **Tema 14** | Teknika e dizajnit | 2 orë |
| **Tema 15** | Koleksioni | 2 orë |





## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Blloku i tendencave të modës”

**Drejtimi:** **Tekstil-konfeksione**
**Niveli:** **III**
**Klasa:** **13**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| **Titulli dhe Kodi** | **BLLOKU I TENDENCAVE TË MODËS** | M-10-851-12 |
|---|---|---|
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer grumbullimin, ekzaminimin dhe vlerësimin e informacionit të nevojshëm për të kuptuar mekanizmin e zhvillimit të një koleksioni. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 33 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të II, të drejtimit mësimor Tekstil-konfeksione. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi kryen përzgjedhjen e një periudhe historike (që ka influencuar historinë e modës) dhe përgatitjen e një prezantim lidhur me të.**<br>***Përmbajtja:***<br>- Përgatitja e vendit të punës.dhe mjeteve të punës.<br>- Paraqitja e siluetës.<br>- Paraqitja e ngjyrave.<br>- Paraqitja e pëlhurave.<br>- Paraqitja e trendeve.<br>- Paraqitja e momenteve historike.<br>- Prezantimi i materialit.<br>- Pastrimi i vendit të punës.<br>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli.<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;<br>- të paraqesë siluetën e veshjeve për periudhën e caktuar historike;<br>- të paraqesë ngjyrat më popullore të përdorura gjatë kësaj periudhe historike;<br>- të paraqesë llojet e pëlhurave të përdorura në këtë periudhë historike;<br>- të paraqesë trendet e veshjeve në këtë periudhë historike; |

- të praraqesë momentet historike dhe personat që kanë influencuar modën e veshjeve gjatë kësaj periudhe hostorike;
- të prezantojë, saktë, materialin e përgatitur;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 2 Nxënësi grumbullon materiale të ndryshme, lidhur me tendencat e modës.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Sigurimi i volumit të veshjeve.
- Grumbullimi i siluetave.
- Grumbullimi i ngjyrave.
- Grumbullimi i pëlhurave/lëkurave.
- Grumbullimi i trendeve.
- Grumbullimi i aksesorëve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për grumbullimin e materialeve të ndryshme, lidhur me tendencat e modës;
- të grumbullojë materiale, lidhur me volumin e veshjeve;
- të grumbullojë materiale, lidhur me siluetat e veshjeve;
- të grumbullojë materiale mbi ngjyrat;
- të grumbullojë materiale mbi llojin e pëlhurave apo lëkurave;
- të grumbullojë materiale lidhur me trendet e veshjeve;
- të grumbullojë materiale lidhur me aksesorët;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3 Nxënësi seleksionon informacionin e marrë për koleksionin**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Seleksionimi i informacionit mbi siluetat.
- Seleksionimi i informacionit mbi ngjyrat.
- Seleksionimi i informacionit mbi pëlhurat apo lëkurat.
- Seleksionimi i informacionit mbi aksesorët.
- Pastrimi i vendit të punës.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për seleksionimin e informacionit të marrë për koleksionin e ri;
- të seleksionojë informacionin e duhur mbi siluetat;
- të seleksionojë informacionin e duhur mbi ngjyrat;
- të seleksionojë informacionin e duhur mbi pëlhurat apo lëkurat;
- të seleksionojë informacionin e duhur mbi aksesorët e veshjeve;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi analizon informacionin e marrë për koleksionin.**

***Përmbajtja:***
- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Analiza e detajeve të tendencës.
- Analiza e siluetave.
- Analiza e ngjyrave.
- Analiza e llojit të pëlhurave apo lëkurëve.
- Analiza e trajtimit të pëlhurës dhe lëkurës.
- Analiza e tendencës së aksesorëve.
- Plotësimi i tabelave përmbledhëse.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për analizimin e informacionit të marrë;
- të analizojë detajet e tendencës, pasi i ka identifikuar ato;
- të analizojë format e siluetës, pasi i ka identifikuar ato;
- të analizojë ngjyrat e tendencës, pasi i ka identifikuar ato;
- të analizojë tendencën e llojit të pëlhurave apo lëkurëve;
- të analizojë llojet e trajtimeve të pëlhurave apo lëkurave, për të krijuar efekte speciale mbi to;
- të analizojë tendencën e aksesorëve, pasi i ka identifikuar ato;
- të plotësojë tabelat përmbledhëse me informacionin e nevojshëm për fillimin e punës;

- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 5 Nxënësi përzgjedh pëlhurat / lëkurat për koleksionin.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e përbërjes së pëlhurave.
- Përzgjedhja e strukturës së thurjes së pëlhurave.
- Përzgjedhja e ngjyrave / dizenjove të pëlhurave.
- Përzgjedhja e llojit të lëkurëve.
- Përzgjedhja e ngjyrave të lëkurëve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për përzgjedhjen e pëlhurave / lëkurave, për koleksionin e ri;
- të përzgjedhë pëlhurat, sipas përbërjes fibrore të tendencës;
- të përzgjedhë pëlhurat, sipas strukturës së thurjes së tendencës;
- të përzgjedhë pëlhurën, sipas ngjyrave apo dizenjove të tendencës;
- të përzgjedhë llojin e lëkurave, sipas tendencës;
- të përzgjedhë lëkurat, sipas ngjyrave të tendencës;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno–sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksonimit, dyqanet dhe magazinat e lëndëve të para.
- Mësimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete për përcaktimin e tendencës së modës.
- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për grumbullimin e informacionit, seleksionimin dhe përdorimin e informacionit të marrë për realizimin e një koleksioni me temë tendence.
- Nxënësi duhet të angazhohet konkretisht në përcaktimin dhe përzgjedhjen e lëndës së parë bazë për realizimin e koleksionit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi

| | |
|---|---|
| | bazën e demostrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:<br>- kompjutera;<br>- adresa të ndryshme interneti të shoqatave apo institucioneve të modës;<br>- lloje të ndryshme të revistave dhe librave të modës;<br>- lloje të ndryshme të teksileve dhe lëkurëve;<br>- lloje të ndryshme filetosh, dantellash, kopsash, butonash, etj.<br>- udhëzues  për zhvillimin e koleksionit. |

## 2. Moduli "Dizenjimi në tekstil-konfeksione"

**Drejtimi: Tekstil-konfeksione**
**Niveli: III**
**Klasa: 13**

| PËRSHKRUESI I MODULIT | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **DIZENJIMI NE TEKSTIL-KONFEKSIONE** | M-10-852-12 |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të prezantuar dizenjimin e nje tendence mode dhe koleksionin e tij. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të II, të drejtimit mësimor Tekstil-konfeksione. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** **Nxënësi realizon formën e figurës së njeriut, nga statikja në pozicione të lëvizshme.**<br>***Përmbajtja:***<br>- Përgatitja e vendit të punës<br>- Përgatitja e mjeteve të punës.<br>- Përzgjedhja e materialeve kryesore dhe ndihmëse.<br>- Krijimi i një stili personal.<br>- Skicimi i figurës së njeriut në pozicion statik ballor.<br>- Skicimi i figurës së njeriut në pozicione statike te ndryshme.<br>- Skicimi i figurës së njeriut në pozicione të lëvizshme të ndryshme.<br>- Pastrimi i vendit të punës.<br>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli.<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin e punës;<br>- të përgatisë mjetet e punës, për vizatimin e figurës së njeriut;<br>- të përzgjedhë materialet kryesore dhe ndihmëse, për realizimin e vizatimit;<br>- të krijojë një stil të tijin personal;<br>- të skicojë figurën e njeriut në pozicion statik, të drejtë, ballor;<br>- të skicojë figurën e njeriut në pozicione statike me pamje të ndryshme (anësore, majtas-djadhtas mbrapa);<br>- të skicojë figurën e njerit në pozicione të ndryshme ne | |

lëvizje;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 2 Nxënësi vesh figurën e njeriut në pozicione të ndryshme.**

***Përmbajtja:***
- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.
- Perzgjedhja e materialeve dhe aksesorëve.
- Veshja e figurës së njeriut në pozicion statik.
- Përzgjedhja e modelit të veshjes.
- Skicimi i figurës së njeriut.
- Paraqitja e modelit të veshur.
- Skicimi i elementeve (aksesorëve), kompletues të veshjes..
- Skicimi i aksesoreve, shoqërues të veshjes;
- Vizatimi i tipeve të ndryshme të bluzave.
- Vizatimi i tipeve të ndryshme të pantallonave.
- Vizatimi i llojeve të ndryshme të fustaneve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për veshjen e figurës së njeriut në pozicione të ndryshme;
- të përzgjedhë materialet dhe aksesorët e duhur për punë;
- të veshë figurën e njeriut në pozicion statik, nëpërmjet lapësit;
- të përzgjedhë modelin e veshjes;
- të skicojë figurën e njeriut të veshur, në dritë hije;
- të paraqesë, me forme dritë hije, modelin e veshur;
- të skicojë elementët (aksesorët) e tjerë, që kompletojnë veshjen (çantë, këpucë, sandale, doreza);
- të skicojë elementët e tjerë, që shoqërojnë veshjen, si zinxhir, kapele, bizhu, butona, fileto, rrip;
- të vizatojë tipe të ndryshme bluzash;
- të vizatojë tipe të ndryshme pantallonash;
- të vizatojë lloje të ndryshme fustanesh;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3 Nxënësi përdor teknika të ndryshme të ngjyrimit**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve.
- Përdorimi i akuarelit.
- Përdorimi i temperës.
- Përdorimi i pastelit.
- Përdorimi i lapustinës.
- Përdorimi i materialeve të ndryshme të riciklueshme.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ngjyrimin me teknika të ndryshme;
- të përzgjedhë materialet, që nevojiten për teknikat e ngjyrimit;
- të përdorë ngjyrimin me akuarel në modelin e vizatuar;
- të përdorë ngjyrimin me tempera në modelin e vizatuar;
- të përdorë ngjyrimin me pastel në modelin e vizatuar;
- të përdorë ngjyrimin me lapustina në modelin e vizatuar;
- të përdorë materiale të ndryshme të riciklueshme për ndërtimin e një kolazhi;
- të pastrojë vendin e punës, duke rrespektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi përdor teknika të ndryshme të dizenjimit në veshje.**

***Përmbajta***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Perzgjedhja e materilave për dizenjmin në veshje.
- Dizenjimi i modeleve të ndryshme të pantallonave.
- Dizenjimi i modeleve të ndryshme te bluzave.
- Dizenjmi i modeleve të ndryshme të fustaneve.
- Dizenjimi i modeleve të ndryshme të jakave.
- Dizenjimi i modeleve të ndryshme të mëngëve.
- Diznjemi i modeleve të ndryshme të xhepave.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për dizenjimin e veshjeve;
- të përzgjedhë materialet per dizenjimin e veshjeve me teknika të ndryshme dizenjimi;
- të dizenjojë modele të ndryshme pantallonash;
- të dizenjoje modele të ndryshme bluzash;
- të dizenjojë modele të ndryshme fustanesh;
- të dizenjojë modele të ndryshme jakash;
- të dizenjojë modele të ndryshme mëngësh;
- të dizenjojë modele të ndryshme xhepash;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit .

**RM 5 Nxënësi grumbullon informacionin, lidhur me dosjen e tendencës së modës.**

***Përmbajtja:***
- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.
- Grumbullimi i informacionit lidhur me stilin.
- Grumbullimi i informacionit lidhur me ngjyrat.
- Përzgjedhja e informacionit mbi tendencën e modes.
- Perzgjedha e materialeve, që do të përdorë në veshjet në manikin.
- Përdorimi i një stili personal.
- Vizatimi i modeleve të koleksionit.
- Përdorimi i tendencës së modës.
- Vizatimi i elementit të konfeksionit.
- Realizimi i produktit të koleksionit.
- Formimi i imazhit të veshjes në manikin.
- Ndërthurja e materialeve të ndryshme në manikin.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për grumbullimin e i nformacionit;
- të grumbullojë informacionin lidhur me llojin e stilit që është në modë;
- të grumbulloje infrmacionin lidhur me ngjyrat që janë në modë;
- të përzgjedhë informacionin mbi tendencën e modës.
- të pëzgjedhë materialet që do të përdorin në veshjet në manikin (pëlhurë, materiale të riciklueshme, lëkura të

| | |
|---|---|
| | llojeve të ndryshme);<br>- të përdorë stilin e tij personal;<br>- të vizatojë modele të koleksionit, që do të realizojë (psh fustan) në letër;<br>- të përdorë tendencën e modës;<br>- të vizatojë elementin e koleksionit, që do të realizojë;<br>- të realizojë produktin e përzgjedhur nga koleksioni;<br>- të formojë imazhin e veshjes në manikin;<br>- të ndërthurë materiale të ndryshme, për ndërtimin e një mulazhi në manikin;<br>- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;<br>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit . |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë, si dhe të organizohen vizita njohëse në atelie të ndryshme të veshjeve.<br>- Mesimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete për përcaktimin e materialeve prej pambuku dhe mëndafshi, si dhe aksesorëve të ndryshme si fileto, lloje të ndryshme tantellash, në përshtatje me ngjyrat e materialit të përzgjedhur.<br>- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për skicimin e figurës së njeriut, veshjen e figurës së njeriut, përdorimin e teknikave të ndryshme te njeriut si dhe realizimin e një koleksioni veshjesh.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë në këtë modul. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:<br>- lloje të ndryshme të teksileve prej pambuku, mëndafshi dhe lëkurave të ndryshme;<br>- lloje të ndryshme filetosh dhe tantellash;<br>- kompleti i veglave dhe i materialeve për skicimin, dizenjimin, ngjyrimin, si dhe realizimin e veshjeve në manikin;<br>- udhëzues dhe rregullore për kushtet teknike për skicimin dhe modelimin e veshjeve në manikin. |





**3. Moduli "Ndërtimi i kallëpeve në tekstil-konfeksione"**

**Drejtimi:** **Tekstil-konfeksione**
**Niveli:** **III**
**Klasa:** **13**

| PËRSHKRUESI I MODULIT | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **NDËRTIMI I KALLËPEVE NE TEKSTIL-KONFEKSIONE** | M-10-853-12 |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të përgatitur skicat bazë dhe për të realizuar kartmodelet e ndryshme të koleksionit. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të II, të drejtimit mësimor Tekstil-konfeksione. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** **Nxënësi ndërton skicat bazë të modelit të koleksionit**<br>***Përmbajtja:***<br>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.<br>- Nxjerrja e masave.<br>- Ndërtimi i skicave të modelit.<br>- Kontrolli i skicave të prerjes.<br>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.<br>- Prerja e kallëpeve.<br>- Pastrimi i vendit të punës.<br>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli.<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ndërtimin e skicave bazë të modelit të koleksionit;.<br>- të nxjerrë masat për modelim, nga tabela e përmasave;<br>- të ndërtojë skicat bazë të modelit;<br>- të kontrollojë saktësinë e skicave përkatëse të prerjes;<br>- të vendosë saktë shenjat përkatëse të refermit;<br>- të presë kallëpet përkatëse;<br>- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;<br>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. | |

**RM 2** **Nxënësi zhvillon skicat bazë, sipas modelit të koleksionit.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Modifikimi i skicave bazë.
- Kontrolli i skicave të modifikuara.
- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit
- Prerja e kallëpeve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për zhvillimin e skicave bazë;
- të modifikojë skicat bazë, sipas modelit të koleksionit;
- të kontrollojë saktësinë e skicave të modifikuara;
- të vendosë saktë shenjat përkatëse të refermit;
- të presë kallëpet përkatëse, sipas skicave të modifikuara;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3** **Nxënësi realizon ndërtimin e plan-vendosjes së elementëve të modelit në plan.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Planvendosja e elementëve të modelit.
- Ekonomizimi i lëndës së parë dhe atyre ndihmëse.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e plan-vendosjes së elementëve të modelit në plan;
- të vendosë elementët e modelit në plan, sipas drejtimit të duhur;
- të ekonomizojë lëndën e parë dhe ato ndihmëse, sipas vendosjes së elementëve të modelit në plan;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të teksitil-konfeksonimit.<br>- Mësimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete për teknikat e zhvillimit të skicave bazë në modelet e ndryshme.<br>- Mësimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete për planvendosjen e kallëpeve në plan duke ekonomizuar materialet bazë<br>- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për ndërtimin e skicave bazë, zhvillimin e tyre sipas modeleve si dhe në planvendosjen e elementëve të modelit për të ekonomizuar materialet bazë.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:<br>- letër<br>- kompleti i veglave dhe i materialeve për modelimin dhe prerjen e kallëpeve.<br>- udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen dhe planvendosjen e kallëpeve. |

**4. Moduli "Realizimi i prototipit dhe prezantimi i koleksionit"**

**Drejtimi:** **Tekstil-konfeksione**
**Niveli:** **III**
**Klasa:** **13**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe Kodi** | **REALIZIMI I PROTOTOTIPIT DHE PREZANTIMI I KOLEKSIONIT** | M-10-854-12 |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të realizuar prototipet e elementëve të koleksionit, si dhe prezantimin e këtij koleksioni. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të II, të drejtimit mësimor Tekstil-konfeksione. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1 Nxënësi pret pjesët përbërëse të prototipit.**<br>***Përmbajtja:***<br>- Përgatitja e vendit të punës.<br>- Përgatitja e mjetet të punës.<br>- Përgatitja e lëndës së parë dhe atyre ndihmëse për prerje.<br>- Vendosja e kallëpeve.<br>- Prerja e materialeve.<br>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.<br>- Pastrimi i vendit të punës.<br>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>- Vëzhgim me listë kontrolli.<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>- të përgatisë vendin e punës;<br>- të përgatisë mjetet e punës, për prerjen e pjesëve të prototipit;<br>- të përgatisë lëndën e parë dhe ato ndihmëse për prerje, duke i shtruar saktë;<br>- të vendosë kallëpet mbi lëndën e parë dhe ato ndihmëse, sipas plan-vendosjes;<br>- të presë materialet, sipas elementëve përbërës të modelit, me metodën klasike;<br>- të vendosë, mbi pjesët përbërëse të modelit, shenjat përkatëse të refermit për qepje, sipas kallëpeve;<br>- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare; | |

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 2 Nxënësi qep prototipin.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Qepja e prototipit.
- Hekurosja e e prototipit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për qepjen e artikullit;
- të përgatisë mjete e punës;
- të qepë prototipin, sipas teknikave përkatëse të qepjes;
- të hekurosë artikullin e përfunduar, sipas teknikave përkatëse të hekurosjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3 Nxënësi kryen e provën e qëndrimit në trup të prototipit.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Kryerja e provës së qëndrimit në trup.
- Identifikimi i problemeve.
- Modifikimi i kallëpeve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë mjetet e punës për realizimin e provës së prototipit;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të prototipit, në një manekin;
- të identifikojë problemet nga prova e kryer;
- të modifikojë kallëpet pas identifikimit të problemit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar regullat

higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi përgatit artikullin e koleksionit.**

***Përmbajta:***
- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Prerja e artikullit të koleksionit.
- Qepja e artikullit të koleksionit.
- Dekorimi i artikullit të koleksionit.
- Hekurosja e artikullit të koleksionit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për përgatitjen e artikullit të koleksionit;
- të presë pjesët përbërse të artikullit të koleksionit, në bazë të kallëpeve;
- të qepë artikullin e koleksionit, sipas skedave teknike (teknika të qepjes industriale);
- të dekorojë artikullin e koleksionit, sipas skedave teknike.
- të hekurosë artikullin e koleksionit, sipas teknikave përkatëse të hekurosjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit .

**RM5 Nxënësi realizon prezantimin e koleksionit**

***Përmbajtja:***
- Përgatitja e albumit.
- Përgatitja e sfilatës.
- Përllogaritja e kostos së veshjeve të koleksionit.
- Përllogaritja e çmimit të shitjes.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përgatisë albumin me modelet e koleksionit;
- të përgatisë sfiatën me modelet e koleksionit;
- të përllogarisë koston e modeleve të koleksionit të përgatitur;
- të përllogarisë çmimin e shitjes së modeleve të koleksionit, duke mbajtur parasysh koston e prodhimit.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | - Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksonimit.<br>- Mesimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demostrime konkrete lidhur me etapat e realizimit të prototipit të modelit të ri.<br>- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për shtrimin e materialeve për prerje, prerjen, qepjen,kryerjen e provës, identifikimin e problemeve, korigjimin e problemeve si dhe dekorimin e artikujve të koleksionit.<br>- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:<br>- lloje të ndryshme të pëlhurave të endura, të thurura apo lëkurë;<br>- letra të përmasave të ndryshme, komplete vizoresh, gërshërë;<br>- lloje të ndryshme filetosh, tantellash, zbukurimesh, etj;<br>- manikinë, komplet i veglave dhe i materialeve për modelimin, prerjen qepjen, zbukurimin e artikujve të koleksionit;<br>- manekinë, aparat fotografik;<br>- udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen dhe qepjen e veshjeve apo aksesorëve të veshjes. |